



**N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.**  
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.  
e-mail: [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com)  
[www.pallatirinise.com](http://www.pallatirinise.com)  
**Dt: 15.06.2026**

Në bazë të dispozitave të nenit 7 të Rregullores me nr 1/333 të datës 24.02.2026 për Procedurën e Dhënies me Qira të Hapësirave, dhe pas identifikimit nga Zyra për Marrëdhënie me Klient, Marketing dhe Promocion për hapësirat e lira sipas nenit 12, dhe bazuar në vendimin e datës 15.06.2026 Kryeshefi Ekzekutiv, **Shpend Bilalli** N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A., me seli në Prishtinë, me datën 15.06.2026, mori këtë:

### FTESË PËR OFERTË

N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A. fton të gjitha subjektet e interesuara:

- Personat juridik (për ushtrim të veprimtarisë – afarizëm),
- Personat fizik dhe juridik (për depo),  
të aplikojnë për marrjen me qira të hapësirave për një periudhë të caktuar.  
Hapësirat e destinuar për persona juridik – hapësira afariste:

Nr.	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi për m <sup>2</sup>
1.	Lok. Nr. 32,33 / QT16	34.71 m <sup>2</sup>	18.92€ Neto
2.	Lok. Nr. 21 / QT9	92.06 m <sup>2</sup>	18.92€ Neto
3.	Lok. Nr. 41 / QT22	254.59 m <sup>2</sup>	18.92€ Neto
4.	Lok. Nr. 49/ QT29	150.16 m <sup>2</sup>	11.87€ Neto
5.	Lok. Nr. 13 dhe 16 / QT6	231.76m <sup>2</sup>	18.92€ Neto
6.	Lok. Nr. 63/ QT32	17.19 m <sup>2</sup>	24.65€ Neto
7.	Zyre nr. 06 / SU006 (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhes në pjesën jugore të sallës universal)	12.28m <sup>2</sup>	10.89€ Neto
8.	Zyre nr. 07 / SU007 (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhes në pjesën jugore të sallës universal)	12.18 m <sup>2</sup>	10.89 € Neto
9.	Zyre nr. 08 / SU008 (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhes në pjesën jugore të sallës universal)	11.96 m <sup>2</sup>	10.89 € Neto
10.	<b>DEPOT E SPORTIT</b>		
11.	Depo nr. SU081 (përball trim kabinetit në korridorin e Sallës së Vogël të Sportit DEPO NEN SHKALL)	112.5 m <sup>2</sup>	3.58 € Neto
12.	Depo nr. SU076 (ish Sigurimit në korridoret e Sallës së Vogël të Sportit)	27.58 m <sup>2</sup>	3.58 € Neto
13.	Depo nr. 016/138 (SU058 )	34.2 m <sup>2</sup>	3.58 € Neto

#### Vërejtje:

Për hapësirat sportive, mund të aplikojnë vetëm federatat dhe klubet sportive, pasi ato janë të destinuara për veprimtari sportive.

#### Afati i kontratës:

Një (1) vit nga data e lidhjes së kontratës.

#### Dokumentet që duhet të dorëzohen:

1. Formulari i aplikimit i cili mund të shkarkohet përmes ueb faqes/emailit zyrtar,
2. Kopje e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe numrit fiskal me të dhëna përkatëse;
3. Kopje e dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor të biznesit;
4. Oferta financiare – çmimi për m<sup>2</sup> (pa TVSH);
5. Vërtetim nga ATK-ja që dëshmon se biznesi është aktiv;
6. Të dhënat e arkës fiskale;
7. Dëshminë e pageses për aplikim në vlerë prej 300 euro e cila paguhet në xhironlogaritë e Pallatit,

#### Kriteret për përzgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm:

1. Çmimi më i lartë se sa çmimi fillestar i shpallur për m<sup>2</sup>;
2. Tarifa e aplikimit është 300,00 €, e cila paguhet në xhironlogari:
3. 17-08-0206-000-000-56 (NLB)
4. 20-33-0002-180-440-76 (TEB)
5. 2415-1306-0000-2579 (PriBank)

Tarifa kompensohet me faturën e parë të qirasë.

- Nëse ofertuesi i përzgjedhur tërhiqet nga kontrata, tarifa nuk i kthehet.
- Ofertuesve të pazgjedhur, tarifa u kthehet.

#### Ofertat nuk do të merren parasysh në rastet kur:

1. Ofertuesi ka qenë qiramarrës i papërgjegjshëm më parë;
2. Oferta nuk përmban të gjitha dokumentet e kërkuara;
3. Oferta arrin pas datës dhe orës së përcaktuar.

#### Afati i dorëzimit të ofertave:

Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur më datë **24.06.2026, nga ora 10:00 deri në ora 11:30**

në Zyrën e Arkivës – N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet:

- Emri i ofertuesit
- Numri i hapësirës
- E-maili zyrtar
- Numri i telefonit

#### Hapja e ofertave:

Ofertat do të hapen nga Komisioni për Vlerësim në prani të ofertuesve,

10 minuta pas përfundimit të afatit të dorëzimit – pra më **24.052026, deri në ora 11:40,**  
në zyrë e Drejtorisë së N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.

#### Vizitat në hapësira:

Të gjithë të interesuarit mund t'i vizitojnë hapësirat nga **15.06.2026 deri më 24.06.2026 në ora 10:00,**

çdo ditë pune, nga ora 10:00 – 15:00,

duke u lajmëruar te Recepcioni i N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.

#### Kërkesa / Aplikacioni mund të merret:

- Në e-mail: [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com)
- Në uebfaqen zyrtare: [www.pallatirinise.com](http://www.pallatirinise.com)
- Fizikisht në Recepcionin e N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.

Për më shumë informata, jeni të mirëpritur të kontaktoni me zyrën përkatëse.